



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 109611 Prot.

Elbasan, më 12.12. 2019

VENDIM

Nr. 179 Datë: 24.12.2019

***“PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË ELBASAN
PËR VITIN 2020”***

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____ .12.2019, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Administrata dhe Kryetari i Bashkisë Elbasan “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan për vitin 2020”, bazuar në:

- Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin e veterinarisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar;
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”;
- Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/ bashkive”;

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 179, datë 09.03.2016 “Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit”;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 632, datë 11.06.2009 “Për tarifat në sektorin e Kullotave”;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 783, datë 10.11.2011 “Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 7, datë 04.01.2012 “Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare”, i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 469, datë 03.06.2015, “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licensave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të ujërave në Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”, i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 07.03.2018 “Përmetodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 27.06.2002 “Për tarifat e shërbimeve që kryen Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj”;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 707, datë 12.10.2016 “Për tarifën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, të ofruar nga bashkitë e pajisura me stacione të këtij shërbimi, në territorin e bashkive që nuk kanë stacione të shërbimit të MZSH-së”;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 09.11.2016 “Për mënyrën dhe kriteret e llogaritjes së shpenzimeve për shuarjen e zjarreve në objektet e siguruar nga zjarri dhe administrimin e përdorimin e të ardhurave, për llogari të shërbimit vendor MZSH-së”;

VENDOSI:

1. Të miratojë nivelin e taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat përgjegjëse për vjeljen e tyre si dhe nivelin e gjobave për kundravajtjet, si mëposhtë vijon:

- Tabela A. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme “ndërtesë”;
- Tabela A/1. Taksa mbi tokën bujqësore;
- Tabela A /2. Taksa mbi truallin (jo hapësirë publike);
- Tabela B. Taksa e fjetjes në hotel;
- Tabela C. Taksa e ndikimit në infrastrukturë;
- Tabela C/1. Taksë për objektet në proces legalizimi;
- Tabela C/2 .Vendosja e garancisë financiare për heqjen e inerteve;
- Tabela D. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
- Tabela E. Taksa për vendosjen e tabelës;
- Tabela F. Tarifat Vendore;
- Tabela F/1.Tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit;
- Tabela F/2. Tarifat e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, shërbimit në tregje dhe zgjatjeve të orarit;
- Tabela G. Tarifa për zënien e hapësirave publike;
- Tabela H. Tarifat vendore të transportit;
- Tabela H/1. Tarifat për liçensa/autorizime/çertifikata;
- Tabela H/2. Tarifë për dhënie liçense për tregtimin e naftës bruto, gazit dhe nënprodukteve të tyre;
- Tabela I. Tarifat vendore për popullatën;
- Tabela J. Tarifat e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Projekteve;
- Tabela K. Tarifat vendore të veterinarisë;
- Tabela L. Tarifa vendore të shërbimeve të institucioneve vartëse;
- Tabela L/1. Tarifat vendore mbi shërbimin e varrimit;
- Tabela L/2. Tarifat vendore për shfrytëzimin e truallit publik për tubacionet, kabllo të telefonike, fibrën optike;
- Tabela L/3. Tarifat vendore për pyjet dhe kullotat;
- Tabela L/4. Tarifa për sektorin e bujqësisë;
- Tabela L/5. Tarifa për përdorimin e kullotave dhe livadheve për kullotje;

- Tabela N. Tarifat e shërbimeve që kryhen nga Struktura e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

PAKETA FISKALE PËR TAKSAT E TARIFAT VENDORE 2020

Tabela A

1. Tabela A - Taksa mbi pasurinë e paluajtshme “ndërtesë”

Vlera e taksës së ndërtesës do të përlogarit sipas aneksit 1 dhe 2 të V.K.M nr. 132 “Përm Metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, e ndryshuar.

Për ndërtesat të cilat shërbejnë për banim

a. Të bëhet **ulje me 20%** e shkallës së taksës (shkalla e taksës nga 0.05 % shkon në 0.04%) për sipërfaqjet ndërtesë banesë në qytet (Shembull: $Vlera\ për\ m^2 = 1\ m^2 \times 0,04\ \% \times 50.300 = 20.120\ lekë$).

b. Të bëhet **ulje me 30%** të çmimit mesatar referues për sipërfaqjet ndërtesë banesë në të gjitha Njësitë Administrative (çmimi nga 50,300 shkon në 35,210) (Shembull: $Vlera\ për\ m^2 = 1\ m^2 \times 0,05\ \% \times 35,210 = 17.605\ lekë$).

Për ndërtesat të cilat shërbejnë jo për banim

Aneksi 2

ÇMIMET MESATARE PËR METËR KATROR SIPËRFAQE NDËRTIMI PËR NDËRTESAT QË NUK SHËRBEJNË PËR BANIM

1. Çmimi për metër katror sipërfaqje ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi, shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqjes së banimit. Në këtë kategori do të përfshihen edhe njësitë tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhimi, tregtimi ose/edhe shërbime me pakicë. (Shembull: $Vlera\ për\ m^2 = 1\ m^2 \times 0,2\ \% \times 75,450 = 150,9\ lekë$).

1.a. Çmimi për metër katror sipërfaqje ndërtimi/njësi ku nuk kryhet aktivitet ekonomik është 120.7¹ lekë/m² në vit.

2. Çmimi për metër katror sipërfaqje ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqjes së apartamenteve të banimit. (Shembull: $Vlera\ për\ m^2 = 1\ m^2 \times 0,2\ \% \times 35,210 = 70.42\ lekë$)

¹ Të bëhet ulja me 20% e çmimit mesatar referues ($75,450 - 20\% = 60,360$. Vlera për $m^2 = 1\ m^2 \times 0,2\ \% \times 60,360\ lekë = 120.7\ lekë$)

3. Çmimi për metër katror sipërfaqje ndërtimi për parkim të hapur është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqjes së apartamenteve të banimit (Shembulli: $Vlera\ për\ m^2 = 1\ m^2 \times 0,2\ \% \times 15,090 = 30.18\ lekë$).

4. Çmimi për metër katror sipërfaqje ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industriale, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqjes së banesave (Shembulli: $Vlera\ për\ m^2 = 1\ m^2 \times 0,2\ \% \times 25,150 = 50.3\ lekë$).

5. Çmimi për metër katror sipërfaqje ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqjes së banesave, me përjashtim të përpunimit ushqimor (Shembulli: $Vlera\ për\ m^2 = 1\ m^2 \times 0,2\ \% \times 15,090 = 30.18\ lekë$).

Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme “ndërtesë” llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit.

Për taksën e pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”, për të cilat nuk disponojmë vlerën e ndërtesës, do të përdoret vlerat referuese për sipërfaqje të banesës, 100 (njëqind) metër katror sipërfaqje për njësi pronësore, për ndërtesat për banim dhe 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqje për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr.7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të ndryshuar ose të ndërtuara para vitit 1991 në Njësitë Administrative.

Për sa i përket kategorisë së ndërtesave që përdoren, shfrytëzohen për veprimtari ekonomike nëse subjekti nuk ka realizuar deklarinë nëpërmjet dorëzimit të dokumentacionit të pronësisë aplikohet vlerësimi me prezumim prej 100 m² për biznesin e vogël dhe 500 m² për kategoritë e tjera të biznesit. Pas dorëzimit të dokumentacionit administrata tatimore duhet të bëjë verifikimet përkatëse.

Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje, por që janë ende të pa shitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambjentit të ndërtesës.

1. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është:

1. Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, për taksën e biznesit të madh dhe të vogël (pagesa kryhet nëpërmjet çdo banke të nivelit të dytë postës, Unioni Financiar Tiranë).

2. Për subjektet familje të cilat disponojnë kontratë me shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a.” pagesa e taksës bëhet çdo muaj si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë nga kjo ndërmarrje, në cilësinë e agjentit tatimor (taksat e popullatës për vitin 2019 dhe detyrimet e prapambetura për klientët e faturuar).

3. Për subjektet familje të cilat nuk disponojnë kontratë furnizimi me ujë me shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a.” afati i pagesës është data 31.10.2020.

Administratorët në Njësitë Administrative dhe Lagjet për ato zona (persona) ku nuk ka kontratë me ujësjellësin.

4. Lagjet dhe Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a.” për debitorët familjarë dhe Drejtoria e Tatimeve Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave për debitorët e taksave vendore.

5. Afati i pagesës së taksës së ndërtesës nga subjektet që ushtrojnë aktivitet ekonomik do të jetë data 31.07.2020.

6. Për mospagesë në afatin e caktuar aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj, por jo më shumë se 12 muaj.

2.Përfshihen nga taksa mbi ndërtesën:

1. Pronat e shtetit dhe të njërive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
2. Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me V.K.M, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
3. Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
4. Banesat sociale në pronësi të bashkive;
5. Pasuritë e paluajtshme – ndërtesa, pronë e subjekteve juridikë ose fizikë, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
6. Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
7. Strukturat akomoduese “Hotel / Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtur të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”;
8. Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;
9. Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
10. Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore;
11. Ndërtesat e invalidëve të punës kur janë kryefamiljarë, pas paraqitjes së dëshmisë së invaliditetit, në ato raste kur familja përbëhet vetëm nga invalidi, ose dhe nga persona në ngarkim të tyre të paaftë për punë ose pensionistë;
12. Përfshimi nga taksa e ndikimit në infrastrukturë e investimeve të kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese me 5 yje, “status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin përkatës për fushën e turizmit.
13. Në qoftë se ndërtesa dëmtohet nga forca madhore, përfshihet nga taksa e ndërtesës në masën 75% të vlerës.
14. Kur ndërtesa tjetërsohet ose zhduket gjatë vitit, detyrimi llogaritet për periudhën e të qenit pronar.

Tabela A/1 - Taksa mbi tokën bujqësore:

	Kategoritë e tokës bujqësore	lekë /ha/vit.
1.	Klasa I	4200
2.	Klasa II	3500
3.	Klasa III	2800
4.	Klasa IV	2300
5.	Klasa V	1900
6.	Klasa VI	1600
7.	Klasa VII	1400

1. Afati për pagesën e taksës së tokës bujqësore është data **31.10. 2020**.
2. Strukturat e caktuara për mbledhjen e kësaj takse janë:
 - a. Drejtoria e Koordinimit me Njësitë Administrative, Njësitë Administrative dhe Lagjet.
 - b. Agjencia e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore.

Shënime:

1. Përfshihen nga taksimi mbi tokën bujqësore sipërfaqjet e mbjellura me kulturat dru frutor dhe vreshtari për 5 vitet e para nga çasti i mbjelljes.
2. Kur toka bujqësore dëmtohet nga fatkeqësi natyrore i zbritet 75 % e vlerës së taksës, për sipërfaqjen e dëmtuar, nga momenti i dëmtimit.

Tabela – A /2 Taksa mbi truallin (jo hapësirë publike)

	Kategoritë dhe nën/kategoritë	lekë/m ² /vit
1.	Për qëllime banimi nga individët ose troje të tjera me destinacion jo ekonomik	0.42
2.	Për qëllime biznesi	18
3.	Për sipërfaqje të gjelbëruara nga bizneset në territorin e tyre	12.6

1. Trualli është pasuria e paluajtshme e emëtuar e tillë sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.
2. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqjes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.
3. Niveli i taksës caktohet në *lekë për metër katror*. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.
4. Për të gjitha kategoritë e trullit që nuk shërbejnë për aktivitet ekonomik do të aplikohet taksa sipas pikës 1 të kësaj table.
5. Struktura e caktuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, Drejtoria e Koordinimit me Njësitë Administrative, Njësitë Administrative dhe Lagjet.
6. Afati për pagesën e taksës së truallit për kategorinë 1 në Njësitë Administrative është data **31.10 2020**.
7. Afati për pagesën e kësaj takse për kategoritë 2 dhe 3 është data **31.07 2020**.
8. Për mospagesë në afatin e caktuar aplikohet gjobë 1.8% çdo muaj, deri në 12 muaj, mbi detyrimin.

Tabela B – Taksa e fjetjes në hotel

Nr.	Baza e taksës	Niveli lekë/netë fjetje/person
1	Hotel me 4 ose 5 yje.	175
2	Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese.	70

1. Me “hotel” kuptohet çdo veprimtari që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet: hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar si dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.
2. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel.
3. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.
4. Subjektet janë të detyruar të bëjnë vetëdeklarimin e numrit të netëve të qëndrimit në hotel shoqëruar me dokumentacionin justifikues për muajin paraardhës.
5. Në rastet kur subjektet nuk mbajnë regjistër të klientëve që flejnë në hotel, administratës tatimore i lind e drejta të bëjë vlerësimin.
6. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave.

7. Afati për pagesën e kësaj takse është data 5 e muajit pasardhës.

8. Për mospagesë në afatin e caktuar aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj, deri në 12 muaj mbi detyrimin si dhe ndërpriset aktiviteti nga strukturat përkatëse.

Tabela C – Taksa e ndikimit në infrastrukturë

	Emërtimi	Niveli i taksës
a.	Strukturë banimi: 1. ndërtime për banim e shërbim apo njësi tregtimi.	4% e çmimit të shitjes për m ²
	Strukturë banimi: 2. për ndërtime për banim e shërbime nga investitorë të tjerë për qëllime jo fitimi.	3% të vlerës së investimit sipas çmimit të Entit Kombëtar të Banesave në fuqi.
b.	Ndërtime të karakterit, turizëm, industrial, bujqësor, ndërtime individuale për qëllime të përdorimit vetjak të ndërtuara nga vetë individët apo me sipërmarrës.	3 % e preventivit real të investimit, më çmimet në bazë të manualit të ndërtimit në fuqi.
c.	Strukturë për qëllime publike, përjashtohen investimet e Bashkisë Elbasan.	2 % të vlerës së investimit sipas çmimit të Entit Kombëtar të Banesave në fuqi.
d.	Rehabilitim rrugësh, ujësjellësash, kanalizimesh, përjashtuar Bashkinë Elbasan.	2 % e vlerës së investimit sipas të preventivit me çmimet në bazë të manualit të ndërtimit në fuqi.
e.	Struktura me funksion privat (prodhime, tregtimi e shërbimi).	3% të vlerës së investimit sipas çmimit të Entit të Banesave në fuqi.
f.	Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte.	0.1% të vlerës të preventivit në bazë të manualit të ndërtimit në fuqi.
g.	Për ndërtesat në proces legalizimi.	0.5% e vlerës së investimit në bazë të çmimit të Entit Kombëtar të Banesave në fuqi.
h.	Për ndryshim funksioni.	3% e vlerës së preventivit në bazë të manualit të ndërtimit.
i.	Rikonstruksione e struktura të ndryshme.	3% e vlerës së preventivit në bazë të manualit të ndërtimit.

j.	Për individët që trajtohen nga emergjenca civile për rrëshqitje të tokës ose nga fatkeqësi të tjera natyrore.	0%
k.	Objekte që zhvillojnë veprimtari pritëse të çertifikuar si agro-turizem sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.	0 %
l.	Për ndërtesat që destinohen për qëllime banimi në zona malore.	0% të vlerës së investimit
ll.	Personat që aplikojnë për t'u pajisur me leje për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e tërmetit të datës 21 shtator 2019, përjashtohen nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë."	0%

1. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit.

2. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njërive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave".

3. Në rastin e ndërtimeve, të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe:

a) për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 deri në 3 për qind e vlerës së investimit;

b) për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, të aeroporteve, të tuneleve, të digave, të ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0, 1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit;

c) për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi;

d) për ndërtesat, që destinohen për qëllime banimi në zonat malore, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 0 për qind e vlerës së investimit, Këshilli bashkiak përcakton me vendim zonat malore për efekt të zbatimit të këtij paragrafi.

4. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve.

Tabela C/1– Taksë për objektet në proces legalizimi

	Kategoritë dhe nënkategoritë për më tepër se një (1) objekt në proces legalizimi	Përqindja e ndikimit në infrastrukturë
1.	Struktura banimi.	3% e ndikimit në infrastrukturë
2.	Struktura me funksione shërbimi dhe njësi.	3% e ndikimit në infrastrukturë
3.	Struktura për qëllime publike si: shkolla, kopshte, spitale etj., (private ose publike).	2% e ndikimit në infrastrukturë

1. Për ndërtesat të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5% e vlerës së investimit.
2. Dokumentacioni i kërkuar do të jetë ai i parashikuar nga drejtoria përkatëse, i cili përfshin kopje të njehësuar të vetëdeklarimit, planvendosje të objektit, si dhe planimetritë me sipërfaqjet përkatëse.
3. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve.

Tabela C/2 – Vendosja e garancisë financiare për heqjen e inerteve

Garancia financiare për heqjen e inerteve	% e vlerës së strukturës së objektit
Garancia financiare për heqjen e inerteve.	4% e vlerës së investimit sipas strukturës së objektit

1. Në mbështetje të pikës 10, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbejeve inerte", subjekti fizik/juridik, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të Bashkisë Elbasan ose kontratë sigurimi, e cila nuk do të jetë më e vogël se 4% e vlerës së strukturës së objektit.
2. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve.

Tabela D- Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme

Nr.	Kategoritë e ndërtesave	Niveli tregues i taksës (Qyteti Elbasan) lekë/m ²	Njesitë Administrative lekë/m ²
1.	Ndërtesa banimi.	300	100
2.	Ndërtesa për tregti e shërbime.	700	300
3.	Ndërtesa të tjera.	500	200

- 1.Kjo taksë vendoset për rastet e transferimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
- 2.Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet.
- 3.Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2%.
- 4.Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.
- 5.Pagesa e taksës së çdo ndërtimi fillon nga momenti i marrjes së lejes së shfrytëzimit, si detyrim i ndërtuesit. Me paraqitjen e kontratave të shitjes prej tij, detyrimi i lind subjektit blerës të sipërfaqjes së ndërtimit.
- 6.Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e cila në rolin e agentit të taksës përfiton 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdh për llogari të buxhetit të Bashkisë Elbasan, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Tabela E – Taksa për vendosjen e tabelës

	Kategoritë	Njësia matëse	Niveli i taksës Qyteti	Niveli i taksës Njesitë administrative
I	Taksë tabelle për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit).			

a	deri në 2 m²	lekë/ m ² /vit	0	0
b	mbi 2 m² deri 10 m²			
	e thjeshtë (pa ndriçim).	lekë/ m ² /vit	10,000	10,000
	me ndriçim të thjeshtë.	lekë/ m ² /vit	15,000	15,000
	elektronike.	lekë/ m ² /vit	20,000	20,000
c	mbi 10 m² deri 20 m²			
	e thjeshtë (pa ndriçim).	lekë/ m ² /vit	8,500	8,500
	me ndriçim të thjeshtë.	lekë/ m ² /vit	12,750	12,750
	elektronike.	lekë/ m ² /vit	17,000	17,000
ç	mbi 20 m² deri 40 m²			
	e thjeshtë (pa ndriçim).	lekë/ m ² /vit	5,500	5,500
	me ndriçim të thjeshtë.	lekë/ m ² /vit	8,250	8,250
	elektronike.	lekë/ m ² /vit	11,000	11,000
d	mbi 40 m²			
	e thjeshtë (pa ndriçim).	lekë/ m ² /vit	4,000	4,000
	me ndriçim të thjeshtë.	lekë/ m ² /vit	6,000	6,000
	elektronike.	lekë/ m ² /vit	8,000	8,000
II	Taksë tabelle për qëllime identifikimi jashtë territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim.			
	Tabela identifikuese.	lekë/ m ² /vit	120	120
III	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme, e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m²			
	e thjeshtë(me/pa ndriçim).	lekë/ m ² /vit	22,500	22,500
	elektronike.	lekë/ m ² /vit	45,000	45,000
IV	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaiere, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.			

të të gjitha llojeve dhe përmasave.	lekë/ m ² /ditë	1,000	1,000
-------------------------------------	----------------------------	-------	-------

1. Detyrimi për taksën e vendosjes së tabelës referuar kategorive I dhe II është vjetor.
2. Për “kategoritë I dhe II” për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës 31.07.2020 të vitit fiskal. Për subjektet që duan të identifikohen me tabelë të re pas datës 31.07.2020, detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë për periudhën nga momenti i deklarimit.
3. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet që nga muaji pasardhës që subjekti regjistrohet pranë QKB dhe taksa paguhet menjëherë. Taksa e tabelës për qëllime identifikimi paguhet për çdo njësi ku subjekti zhvillon aktivitetin, nga muaji pasardhës që regjistrohet pranë QKB.
4. Në rastin e më shumë se një tabele, pavarësisht nga vendndodhja, vetëm njëra do të konsiderohet si tabelë me qëllime identifikuese, ndërsa tabelat e tjera do të konsiderohen si tabela me qëllime reklamuese.
5. Për “kategorinë III” për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës 31.07.2020 të vitit fiskal. Për subjektet e reja detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë sipas periudhës së përcaktuar në kontratën e nënshkruar me strukturat përkatëse të bashkisë Elbasan.
6. Për “kategorinë IV” detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të bashkisë Elbasan dhe paguhet menjëherë.
7. Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.
8. Tabelat kategorizohen në:

a. Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logoja dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një tabele identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë. Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.

b. Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose joballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si: tarraca, lozha, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, për të tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.

c. Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.

9. Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.
10. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga shkronja të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si: mur, fasadë e jashtme e çdo lloji, shtyllë, kolonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë e shkruar, e stampuar apo e pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zënë të gjitha shkronjat, figurat, logot dhe simbolet që formojnë tabelën.
11. Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe shkronja, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produkteve apo shërbimeve që furnizohen nga vetë njësia, ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori tabelle. Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi.
12. Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një tabelle identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij. Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori tabelle.
13. Institucionet e varësisë së Bashkisë Elbasan përjashtohen nga taksa për vendosjen e tabelës.
14. Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave.

F. Tarifat Vendore

Tabela F/1– Tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit

Nr.	Subjekti	Niveli i Tarifës lekë/vit
1.	Subjektet VIP që ushtrojnë aktivitet prodhim metalesh nga skrap i ose minerali, shkrirje e substancave minerale, përpunimi i naftës dhe nënprodukteve të saj, prodhimi i çimentos.	3,360,000
2.	Subjektet VIP që ushtrojnë aktivitet të tillë si: trajtimi i mbetjeve plastike dhe nënprodukteve, industria e	448,000

	peshkut dhe nënprodukteve, grumbullimi dhe asgjësimi i mbetjeve metalike, prodhim polisteroi, apo aktivitete të tjera, që ndikojnë në mjedis.	
3.	Subjektet persona juridik që ushtrojnë aktivitet të tillë si: karrire guri (gurore), shfrytëzim të argjilave, shfrytëzim të lumenjve, që ndikojnë në mjedis.	336,000
